



Prishtinë: 27 Shkurt 2009

## Zyra e Rregullatorit për Energji

Duke marrë parasysh

1. Mandatin ligjor të përcaktuar në Nenin 23 të Ligjit mbi Rregullatorin e Energjisë, të amendamentuar në ligjin Nr. 03/L-080;
2. Dispozitat e Nenit 7 të Rregullës për procedurën e autorizimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese, rrjetave të gazit, linjave direkte elektroenergjetike dhe linjave gypore direkte.
3. Shtojcën A, pika D2 të Pasqyrës së Taksave, të miratuar nga ZRRE me datë 17.01.2006.

Vendos në konsultim publik **propozim listën** e taksave për shqyrtimin e aplikacioneve për autorizim për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese, si në vijim.

<i>Kapaciteti i Instaluar i Gjeneratorit të ri</i>	<i>Çmimi/Euro</i>
<i>Gjeneratori i ri me kapacitet deri 5 MW</i>	<i>1,500.00</i>
<i>Gjeneratori i ri me kapacitet mbi 5 MW deri 10 MW</i>	<i>3,000.00</i>
<i>Gjeneratori i ri me kapacitet mbi 10 MW deri 50 MW</i>	<i>5,000.00</i>
<i>Gjeneratori i ri me kapacitet mbi 50 MW deri 100 MW</i>	<i>7,0000.00</i>
<i>Gjeneratori i ri me kapacitet mbi 100 MW deri 200 MW</i>	<i>20,000.00</i>

Kjo propozim listën e taksave për shqyrtimin e aplikacioneve për autorizim për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese, është punuar në bazë të praktikave dhe përvojave të rregullatorëve rajonal, dhe publikohet si një mundësi për palët e interesuara që të paraqesin komentet e tyre, para se ZRRE të miratoj atë.

Afati i fundit për pranimin e komenteve mbi këtë propozim listë të taksave është, deri me datën 12 Mars 2009.

Komentet duhet të paraqiten me shkrim në adresën:

- "Hamdi Mramori" , Nr 1, 10000 Prishtinë, të adresuara për "Departamentin Ligjor dhe i Licencimit:
- apo në adresën elektronike [ero.legal-licensing@ero-ks.org](mailto:ero.legal-licensing@ero-ks.org) me paragrafin e theksuar në lëndë "Propozim lista e taksave për shqyrtim të aplikacionit për autorizim".